**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**
**Nr. 128 Rep.**
**Nr. 80 Kol.**

# AKT THEMELIMI
# I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# "FDI DISTRIBUTION" SHPK.

Ne Tirane, sot me 17.03.2002, para meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht Z. Agron Gaxho shtetas shqiptar, lindur ne Gramsh me 12.05.1970, i cili me vullnetin e tij te plote e te lire, nenshkruan ne prezencen time Aktin e Themelimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "FDI Distribution". Sh.p.k., me ortak te vetem

1) Ortaku i Vetem Z. Agron Gaxho, nepermjet ketij akti, themelon ne cilesine e Ortakut te Vetem nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "FDI Distribution"Sh.p.k.
   "FDI Distribution"Sh.p.k. do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me Aktin e Themelimit e Statutin e saj.

2) "FDI Distribution"Sh.p.k. ka per objekt:
   - Prodhim si dhe tregetim me shumice dhe pakice tekstilesh e konfeksionesh,
   - Import-eksport e tregtim me shumice e pakice i mallrave e artikujve te ndryshem industriale e bujqesore, cigare, pije alkolike, etj.
   - Prodhim e tregetim te artikujve te ndryshem ushqimore,
   - Konsulence ekonomike,
   - Bar-Restorant dhe hoteleri,
   - Agjensi turistike e agjensi transporti kombetar e nderkombetar mallrash e udhetaresh,
   - Tregtim te karburanteve, lendeve te ndryshme djegese dhe lubrifikanteve, me pakice
   - Sipermarrje e sherbime ne fusha te ndryshme dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e objektit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

3) "FDI Distribution"Sh.p.k. e ka seline e saj ne adresen: Rr. "28 Nentori", Elbasan, Shqiperi. Shoqeria mund te hape filiale, dege dhe zyra perfaqesimi ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj.

4) Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat kohor te pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar shqiptar.

5) Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njeqind mije) leke dhe eshte i ndare ne 100 pjese me nr. rendor nga 1 ne 100 me vlere nominale 1.000 (njemije) leke secila. Kapitali i shoqerise nenshkruhet dhe derdhet teresisht ne te holla nga Ortaku i Vetem.

6) Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem. Administratori i Vetem do te qendroje ne detyre deri ne momentin e revokimit te mandatit tij me vendim te Ortakut te Vetem. Administratori pergjigjet personalisht perballe shoqerise dhe te treteve per shkelje te te ligjit dhe/ose te statutit.
   Z. Besnik Gaxho, shtetas shqiptear, i datelindjes 07.04.1977, emerohet Administrator i shoqerise "FDI Distribution"Sh.p.k.

7) Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe perfundon me 31 Dhjetor 2002.

Une Noteri lexoj me ze te larte tekstin e ketij dokumenti. Z. Agron Gaxho njihet me permbajtjen e tij dhe pasi ai e gjen permbajtjen e Aktit te Themelimit te shoqerise ne perputhje me vullnetin e tij te plote e te lire, nenshkruan rregullisht ne pranine time dhe une Noteri vertetoj kete dokument sipas ligjit.

**N O T E R**

**Z. Agron Gaxho**

Agron Gaxho

Adelina Nuni

PULLE TAKSE
50 LEK

# STATUT
# I
# Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar

"FDI DISTRIBUTION"**SHPK.**

EMERTIMI - FORMA - BAZA LIGJORE

**Neni 1**

Sot me date 18 .03.2002. z. Agron Gaxho shtetas shqiptar, lindur ne Gramsh, me 12.05.1970 ne cilesine e Ortakut te Vetem ka themeluar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "FDI Distribution"Shpk.

**Neni 2**

Shoqeria fiton personalitet juridik nepermjet vendimit te Gjykates se Rrethit Tirane.

**Neni 3**

Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me dispozitat e parashikuara nga ky Statut dhe Akti i Themelimit te saj.

OBJEKTI - SELIA

**Neni 4**

1) "FDI Distribution"Sh.p.k. ka per objekt:
   - Prodhim si dhe tregetim me shumice dhe pakice tekstilesh e konfeksionesh,
   - Import-eksport e tregtim me shumice e pakice i mallrave e artikujve te ndryshem industriale e bujqesore, cigare, pije alkolike, etj.
   - Prodhim e tregetim te artikujve te ndryshem ushqimore,
   - Konsulence Ekonomike,
   - Bar-Restorant dhe hoteleri,
   - Agjensi turistike e agjensi transporti kombetar e nderkombetar mallrash e udhetaresh,

- Tregtim te karburanteve, lendeve te ndryshme djegese dhe lubrifikanteve me pakicë
- Sipermarrje e sherbime ne fusha te ndryshme dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi

**Neni 5**

Shoqeria "FDI Distribution"Shpk. e ka seline e saj ne adresen: Rr. "28 Nentori", Elbasan, Shqiperi.

**Neni 6**

Adresa e ligjshme e ortakut te vetem per çdo marredhenie me shoqerine eshte selia e shoqerise.

**Neni 7**

Shoqeria mund te krijoje filiale, te hape dege e zyra perfaqesimi ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj.

KOHEZGJATJA - KAPITALI

**Neni 8**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat kohor te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar shqiptar.

**Neni 9**

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njeqind mije) Leke dhe eshte i ndare ne 100 pjese me nr. serie nga 1 ne 100 me vlere nominale 1.000 (njemije) leke secila. Kapitali i shoqerise nenshkruhet dhe derdhet teresisht ne te holla nga Ortaku i Vetem.

**Neni 10**

Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme sipas ligjit shqiptar ne fuqi.

**Neni 11**

Ortaku i Vetem pergjigjet per detyrimet e shoqerise karshi te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e shoqerise.

## ORGANET E SHOQERISE

**Neni 12**

Ortaku i Vetem miraton llogarite dhe bilancin e shoqerise, i cili dorezohet nga Administratori brenda 6 muajve nga perfundimi i vitit financiar.

**Neni 13**

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator.
Administratori do te pergjigjet per administrimin e shoqerise, dhe do t'a realizoje ate duke kryer te gjitha veprimet qe ai ne baze te ligjit dhe statutit te shoqerise, i konsideron te nevojshme per realizimin e objektit te shoqerise me perjashtim te atyre qe ky statut dhe ligji ia ka rezervuar ne menyre taksative Ortakut te Vetem.
Administratori do te pergjigjet personalisht perballe shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjit dhe/ose te statutit.

**Neni 14**

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem.
Administratori i shoqerise emerohet z.Besnik Gaxho.
Administratori do te qendroje ne detyre deri ne momentin e revokimit te mandatit te tij me vendimin e Ortakut te Vetem.

**Neni 15**

Eksperti kontabel, ne rastet kur ligji e kerkon detyrimisht emerimin e tij, emerohet dhe vepron ne perputhje me ligjin.

## VITI FINANCIAR I SHOQERISE - LIKUJDIMI

**Neni 16**

Çdo vit fiananciar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.
Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe mbyllet me 31 Dhjetor 2002.

**Neni 17**
Ne çdo moment e per çdo arsye qe arrihet ne shperndarjen e shoqerise, normat per kryerjen e likujdimit dhe emerimin e likuidatorit jane ato qe parashikohen nga ligji shqiptar ne fuqi.

## NORMA REFERUESE - KOMPETENCA

**Neni 18**
Per sa nuk parashikohet ne kete Statut behet referim ne legjislacionin shqiptar ne fuqi ne fushen e shoqerive tregtare.

**Neni 19**
Autoriteti gjyqesor ne Republiken e Shqiperise ka kompetenca ekskluzive per zgjidhjen e te gjitha mosmarreveshjeve qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij statuti, si dhe mosmarreveshjeve qe mund te lindin midis vete shoqerise dhe te treteve.

**Neni 20**
Ky statut i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “FDI Distribution”Shpk. perpilohet ne pese kopje ne gjuhen shqipe me te njejten vlere secila, qe nenshkruhen rregullisht nga Ortaku i Vetem.

**O R T A K U  I  V E T E M**

Z. Agron Gaxho

Agron Gaxho

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 728 Rep.
Nr. 80 Kol.

## VERTETIM

Ne Tirane, sot me 18.03.2002, para meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht Z. Agron Gaxho shtetas shqiptar, lindur ne Gramsh me 12.05.1970, i cili me vullnetin e tij te plote e te lire, nenshkruan ne prezencen time Statutin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "FDI Distribution". Sh.p.k. Une noteri vertetoj kete dokument dhe nenshkrimin e saj sipas ligjit.

NOTERE

